

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6976
E martë, 22 gusht 2023
Çmimi 0.40 €

MBROJTJA E KORRUPSIONIT NGA KRYEMINISTRI



Shkruan: Hajdin ABAZI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SIPAS QEVERISË, PROCESI I ZGJEDHJEVE TË REJA NË VERI PRITET TË DETERMINOHET NË DITËT E ARDHSHME



Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal i Kosovës, Elbert Krasniqi, ka bërë me dije të hënën se procesi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës do të determinohet gjatë ditëve

në vijim. Ai ka theksuar se si ministër ka mbuluar përgjegjësinë e tij duke filluar me udhëzimin administrativ, i cili parasheh të drejtën e qytetarëve për mbledhjen e nënshkrimeve për largimin e kryetarëve nga

detyra përmes peticionit. Ndërkaq nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kanë theksuar se janë të gatshëm t'i organizojnë zgjedhjet e reja në komunat në veri kurdo që kërkojnë institucionet përgjegjëse

DËSHTOI TË ARRIJË PAJTIM ME SHTËPITË BOTUESE PËR TEKSTET SHKOLLORE, MASHTI BËN EKSPERIMENTE ME NXËNËS E PRINDËR



FACE 7

KOSOVA I BASHKOHET DEKLARATËS SË VENDEVE TË G7-S MBI MBËSHTETJEN PËR UKRAINËN



FACE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



KRASNIQI: BRAHIMI DËSHIRONTE QË VETËM BOKSIERËT E KLUBIT TË TIJ TA PËRFAQËSOJNË KOSOVËN

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky, falënderues për avionët F-16, Rusia paralajmëron “përshkallëzim”

KIEV, 21 GUSHT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i ka falënderuar ligjberësit danezë për mbështetjen e tyre ndaj Kievit në luftën kundër pushtimit rus, ndërsa Moskë tha se vendimi i Danimarkës dhe Holandës për të dërguar avionë luftarakë F-16 në Ukrainë do ta përshkallëzojë luftën.

Komentet e Zelenskyt në Kopenhagë të Danimarkës më 21 gusht erdhën një ditë pasi ai njoftoi se Danimarka e ka miratuar dërgimin e 19 avionëve luftarakë të avancuar në Ukrainë. Zelensky tha se edhe Holanda kishte rënë dakord të dërgonte 42 avionë të llojit F-16, megjithëse kryeministri holandez, Mark Rutte, tha se megjithëse vendi i tij i ka 42 avionë në dispozicion, ende nuk është vendosur nëse të gjithë do t'i dhurohen Ukrainës.

Ukraina ka kërkuar vazhdimisht avionë luftarakë F-16 nga partnerët e saj perëndimorë. Danimarka dhe Holanda janë të parat që iu përgjigjën thirrjes. Kiev thotë se i duhen avionët për ta forcuar flotën e dëmtuar të avionëve të epokës sovjetike teksa vazhdon kundërofensivën. Më 20 gusht Zelensky falënderoi Holandën dhe Danimarkën për premtimet e tyre për të dhuruar F-16, duke thënë: “Ne po punojmë e po e bëjmë Ukrainën më të fortë dhe mbrojtjen ajrore ukrainase më të sigurt!” Duke iu drejtuar ligjvënësve danezë, Zelensky tha më 21 gusht se “të gjithë fqinjët e Rusisë janë nën kërcënim nëse Ukraina nuk mbizotëron” në luftën tashmë 18-mujore të nisur nga Moskë.



Anëtarët e NATO-s, Danimarka dhe Holanda, njoftuan për vendimet e tyre për t'i dhuruar F-16 Ukrainës në një deklaratë të përbashkët më 20 gusht, por nuk e specifikuan numrin e avionëve. Danimarka ka sugjeruar që avionët F-16 të saj mund të dorëzohen deri në fund të vitit, pas katër deri në gjashtë muaj trajnim.

Gjatë vizitës së Zelenskyt në një bazë ajrore holandeze më 10 gusht, Rutte nuk dha një numër ose afat kohor për dërgesat, duke treguar se disa nga 42 avionët që Holanda ka në dispozicion do të nevojiteshin për qëllime stërvitore dhe se koha varet nga gatishmëria e ekuipazheve

ukrainase dhe infrastrukturës. “[Avionët] F-16 nuk do të ndihmojnë menjëherë në përpjekjet e luftës. Gjithsesi, ky është një angazhim afatgjatë nga Holanda”, tha Rutte. “Ne duam që ata të jenë aktivë dhe funksionalë sa më shpejt të jetë e mundur. [Nuk do të jenë gat] muajin e ardhshëm, kjo është e pamundur, por shpresojmë që së shpejti”.

Si Holanda ashtu edhe Danimarka janë anëtarë të një koalicioni perëndimor që po trajnon pilotët ukrainas - fillimisht në Danimarkë dhe më pas në Rumani - për t'i drejtuar avionët e sofistikuar F-16. Ndërsa Zelensky refuzoi të thoshte gjatë qëndrimit në Holandë se sa pilotë ukrainas do të trajnoheshin,

Danimarka tha javën e kaluar se trajnimi do të fillonte këtë muaj. Shtetet e Bashkuara të Amerikës autorizuan javën e kaluar Danimarkën dhe Holandën për t'i dorëzuar avionët F-16 të prodhimit amerikan në Ukrainë.

Më 21 gusht, ministri danez i Mbrojtjes, Jakob Ellemann-Jensen, i tha agjencisë së lajmeve Ritzau se Kiev mund t'i përdorë avionët F-16 të dhuruar nga Danimarka dhe Holanda vetëm brenda territorit ukrainas.

“Ne dhurojmë armë me kusht që ato të përdoren për ta përzënë armikun nga territori i Ukrainës. Dhe jo më larg se kaq”, citohet të ketë thënë Ellemann-Jensen. “Këto janë kushtet, qofshin tanke, avionë

luftarakë apo diçka tjetër”.

Por, Rusia më 21 gusht i dënoi vendimet e Danimarkës dhe Holandës për t'i dhuruar këta avionë.

“Fakti që Danimarka tani ka vendosur të dhurojë 19 avionë F-16 në Ukrainë çon në një përshkallëzim të konfliktit”, tha ambasadori rus në Danimarkë, Vladimir Barbin, në një deklaratë të cituar nga agjencia e lajmeve “Ritzau” më 21 gusht. “Duke u fshehur pas një premise se vetë Ukraina duhet t'i përcaktojë kushtet për paqen, Danimarka kërkon me veprimet dhe fjalët e saj që të mos i lërë Ukrainës zgjidhje tjetër veçse ta vazhdojë konfrontimin ushtarak me Rusinë”, tha Barbin.

Zjarret në Greqi shuajnë jetën e një bariu, rrezikohen zonat përreth Athinës



ATHINË, 21 GUSHT - Një burrë u gjet i vdekur shkak i një zjarri që shpërtheu në veri të Athinës më 21 gusht, thanë zjarrfikësit,

të cilët luftuan një zjarr të ri masiv dhe paralajmëruan për një rrezik “ekstrem” nga zjarret në rajonin përreth kryeqytetit,

Athinës. “Një bari i vjetër vrapoi në vathën e tij për t'i shpëtuar kafshët dhe u gjet i vdekur”, tha një zëdhënës i brigadës së

zjarrfikësve për AFP.

Një zjarr i madh shpërtheu në rajonin qendror të Greqisë, Boeotia, rreth 100 kilometra në veri të Athinës, thanë shërbimet e shpëtimit.

Njerëzit që po qëndronin në një plazh dhe në dy komunitete aty pranë u urdhëruan të evakuheshin nga ato zona.

Rreth 56 zjarrfikës dhe katër avionë që hidhnin ujë po luftonin me zjarrin e ri gjatë ditës, tha një zyrtar nga shërbimi i zjarrfikësve për agjencinë e lajmeve AFP. Zjarret vazhduan të digjen edhe për të tretën ditë në pjesën verilindore të Greqisë, pranë qytetit Alexandroupolis.

Ekipet e zjarrfikësve janë vendosur në disa fronte dhe po përpunon ta ndalojnë përparimin e zjarrit drejt Parkut Kombëtar Dadia, që pësoi dëme të konsiderueshme nga zjarret

vitin e kaluar. Të angazhuar në mbarë Greqinë aktualisht janë mbi 200 zjarrfikës, ndërsa me zjarret po luftojnë edhe shumë vullnetarë dhe policë.

Shtatë zjarrfikës dhe një vullnetar u dërguan në spital me lëndime, tha zyrtari nga shërbimi i zjarrfikësve.

Rreth 12 komunitete u evakuuan gjatë fundjavës dhe autoritetet e mbrojtjes civile u kërkuan banorëve të qëndrojnë brenda shtëpive për shkak të tymit. Në këtë zonë është shpallur gjendje e jashtëzakonshme.

Autoritetet e mbrojtjes civile paralajmëruan për një rrezik “ekstrem” zjarri në rajonin përreth Athinës dhe në pjesë të tjera të Greqisë jugore.

Kushtet shumë të nxehta dhe të thata që rritin rrezikun e zjarrit do të vazhdojnë deri të premtën, sipas meteorologëve.

Dështoi të arrijë pajtim me shtëpitë botuese për tekstet shkollë, MASHTI bën eksperimente me nxënës dhe prindër

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) nuk ka arritur marrëveshje me shtëpitë botuese lidhur me furnizimin me libra për nxënës dhe mesimi do të fillojë për dhjetë ditë.

Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, në një konferencë për medie të hënën, ka bërë me dije se janë duke e shqyrtuar mundësinë që transferimi i mjeteve për sigurimin e teksteve shkollë të kalojë në llogaritë e prindërve. Por nuk dihet se kur do t'u dalin paratë prindërve për t'ua blerë librat fëmijëve të tyre. Për t'i përfutur këto para për libra, prindërit duhet të aplikojnë në e-Kosova. "Sivjet jemi duke e shqyrtuar mundësinë që transferimi i mjeteve për sigurimin e teksteve shkollë sipas obligimit ligjor të MASHTI-t të bëhet në llogaritë e prindërve dhe të njëjtët t'i blejnë

tekstet për fëmijët e tyre. Shumë shpejt brenda dy-tri ditëve do të vendoset për këtë rrugë që po e shqyrtojmë. Paralelisht kemi përgatitur edhe platformën për aplikim në platformën e-Kosova me të gjitha detajet e tjera dhe kemi shqyrtuar të gjitha mundësitë që në njërin anë të kemi tekste cilësore për fëmijët dhe kujdes për buxhetin e shtetit", ka thënë ajo.

Nagavci ka shtuar se furnizimi i nxënësve me tekste shkollë për vite me radhë ka qenë mjaft sfidues për shkak të shumë sfidave.

Zëvendësministri i MASHTI-t, Taulant Kelmendi, ka bërë me dije se pas shumë tentimeve për t'i zbritur çmimet në nivelin e përbalueshëm për buxhetin e ndarë, shtëpitë botuese nuk kanë pasur mirëkuptimin. "Së fundmi kanë dërguar letra se çmimet e tyre janë të panegociueshme. Kjo situatë dhe kjo gjendje e krijuar është e papërbalueshme për MASHTI-n dhe buxhetin e shtetit. Ne nuk

mund të kalojmë asnjë skemë të keqshfrytëzimit të taksave të qytetarëve tanë", ka thënë Kelmendi.

Duke reaguar ndaj këtij lajmi, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se mbi 300 mijë familje kosovare do të detyrohen t'i blejnë librat për fëmijët e tyre - të pasigurt nëse ndonjëherë do t'u rimburohen ato të holla. "Përveç rritjes së kostos së jetesës, përmes rritjes së çmimit të energjisë e produkteve bazë ushqimore, papunësisë e korrupsionit masiv, prindërit e rënduar ekonomikisht nga keqeverisja e këtij pushteti duhet t'i blejnë edhe librat për fëmijët e tyre", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Ai thotë se këtë çështje e kishte zgjidhur rreth 15 vjet më parë ish-kryeministri Hashim Thaçi, duke ua lehtësuar sadopak barrën e shkollimit të fëmijëve prindërve përmes sigurimit të librave falas.

Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se këtë

dështim të MASHTI-t do ta paguajnë fëmijët dhe prindërit e tyre. "Nisma e Ministrisë së Arsimit që t'i ngarkojë prindërit me blerjen e librave shkollorë vetëm një javë para se të nisë procesi mësimor është nismë e gabuar, e vonuar, që do të ketë pasoja për gjithë sistemin, posaçërisht për nxënës dhe prindërit e tyre. Shteti nuk duhet t'i nënshtrohet asnjë shantazhi dhe as kushtëzimeve eventuale nga ndonjë shtëpi botuese, por vendimet për gjëra kaq të rëndësishme për procesin mësimor duhet të merren shumë kohë më parë, të bëhen përgatitje dhe të mos pësojë gjithë shoqëria. Pra, kemi një dështim të MASHTI-it meqë krejt në fund paskan marrë çmimet e larta nga shtëpitë botuese dhe tash i ngarkojnë familjet dhe prindërit e fëmijëve t'i blejnë librat", ka shkruar Bajrami në "Facebook".

Ajo ka shtuar edhe disa pyetje: "Çka nëse mjetet financiare që i shpërndan MASHTI-i për këtë

qëllim nuk do të mjaftojnë? Çka nëse s'ka libra mjaftueshëm në treg për nxënësit?"

Ajo ka thënë se mungesat e librave në treg do të jenë të paevitueshme sepse, sipas saj, shtëpitë botuese nuk do të shtypin libra pa u siguruar që do të ketë kërkesë, e kërkesa e prindërve do të dallojë nga ajo e MASHTI-it. "Vitin e kaluar fëmijët tanë e kanë humbur një muaj mesim dhe askush nuk ka marrë përgjegjësi. Ministre, mos i merr në qafë fëmijët sepse kanë humbur një muaj mesim vitin e kaluar. Mos i lë fëmijët pa libra se këtë nuk ta kanë borxh", ka thënë deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami.

Për këtë lajm ka reaguar edhe analisti Imer Mushkolaj. "Qeveria dhe Ministria e Arsimit tash ua komplikojnë jetën qytetarëve edhe më shumë, duke bërë eksperimente me nxënës dhe prindër. Kush po i mëson kaq mbrapsht athu?", ka shkruar Mushkolaj në "Facebook".



Haradinaj: Kurti është i vetmi kryeministër që nuk i beson sistemit të shtetit të vet

Prishtinë, 21 gusht - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka theksuar se Albin Kurti është i vetmi kryeministër që nuk i beson sistemit të shtetit të vet, por krijon sistem paralel. "Ai edhe për operacionet më të

ndjeshme të qeverisjes e të shtetit, që prekin edhe sigurinë kombëtare, angazhon njerëz që janë jashtë institucioneve, por që mjafton të jenë jarana të tij, siç ishte edhe rasti me Ridvan Muharremin", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka shkruar se këto janë ato lidhjet e shkurtra të kapjes së shtetit me miq e dollarë, për të cilat e ka pasur ngritur alarmin këtu e një vit më parë, "...lidhje këto të cilat po dalin në shesh përditë e më shumë", ka shkruar Haradinaj.



Sipas qeverisë, procesi i zgjedhjeve të reja në veri pritet të determinohet ditëve të ardhshme

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal i Kosovës, Elbert Krasniqi, ka bërë me dije të hënën se procesi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës do të determinohet gjatë ditëve në vijim. Ai ka theksuar se si ministër ka mbuluar përgjegjësinë e tij duke filluar me udhëzimin administrativ, i cili parasheh të drejtën e qytetarëve për mbledhjen e nënshkrimeve për largimin e kryetarëve nga detyra përmes peticionit. Ndërkaq nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kanë theksuar se janë të gatshëm t'i organizojnë zgjedhjet e reja në komunat në veri kurdo që kërkojnë institucionet përgjegjëse

të niste një referendum me pyetjen se a duhet të shkarkohet kryetari. "Në këtë referendum duhet të marrin pjesë të paktën 50 për qind e trupës votuese, plus një. Kështu që kjo është baza ligjore që del dhe buron nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale", tha Krasniqi.

Tensionet në këtë zonë janë rritur qysh në fund të majit, kur kryetarët shqiptarë të komunave, të dalë nga zgjedhjet e 23 prillit, kanë hyrë në objektet komunale, përkundër rezistencës së banorëve lokalë serbë.

Protestat e tyre kanë kulmuar edhe në përlëshje të dhunshme me ushtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në zgjedhje të parakohshme për kryetar të komunës mund të shkohet në rast se kryetari aktual jep dorëheqje; në rast se qytetarët kërkojnë shkarkimin e kryetarit të komunës përmes një peticioni të nënshkruar nga 20 për qind e votuesve të komunës përkatëse; si dhe në rast se kryetari i komunës nuk paraqitet në vendin e punës më shumë se një muaj, pa arsye.

Njohësi i proceseve politike në vend, Milazim Krasniqi, ka thënë se ndër veprimet urgjente të

qeverisë Kurti duhet të jetë dorëheqja urgjente e katër kryetarëve në komunat veriore dhe mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve me pjesëmarrjen e serbëve. "Prandaj qeveria Kurti duhet të ndërmarrë veprime konkrete gjatë këtij muaji, që të shmangët skenari i konfliktit të armatosur që është planifikuar nga Rusia për në vjeshtë. Ndër veprimet urgjente duhet të jetë dorëheqja urgjente e katër kryetarëve në komunat veriore dhe mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve me pjesëmarrjen e serbëve. Ata kryetarë janë atje kot dhe nuk përfaqësojnë ndonjë standard demokracie e as barazie. Është marrëzi që Kosova të mbahet peng i mandatit të tyre të kotë. Ata nuk përfaqësojnë askënd, meqë tre prej tyre nuk guxojnë të dalin në zyra, ndërsa njëri nuk guxon të dalë nga zyra. Pra, mbajtja e zgjedhjeve sa më shpejt mund ta rikthejë procesin e integritetit të serbëve në binarë e me këtë e zvogëlon influencën malinje të Ruisë dhe diktatit fashizoid të Serbisë. Nëse kjo nuk bëhet me vendosmëri, atëherë duhet të kërkojë në pista të tjera përgjegjësia e qeverisë Kurti. Jo vetëm në pistën e përgjegjësive politike", ka thënë analisti Milazim Krasniqi.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal i Kosovës, Elbert Krasniqi, ka thënë se procesi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës do të determinohet gjatë ditëve në vijim. Ai nuk dha hollësi lidhur me punën e bërë deri më tani nga grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ që mundëson nisjen e peticionit për largimin e kryetarëve të komunave pasi që tha se udhëzimi administrativ do të jetë gati në fund të muajit. "Si ministri dhe si ministër kam mbuluar përgjegjësinë time duke filluar me udhëzimin administrativ, i cili parasheh të drejtën e qytetarëve

për mbledhjen e nënshkrimeve për largimin e kryetarëve nga detyra", tha Krasniqi për media pas përfundimit të punimeve për zgjerimin e një rruge në Gjakovë. "Kjo nuk është për veriun, kjo mund të aplikohet nesër edhe për kryetarin e Gjakovës apo cilindo kryetar të Kosovës", shtoi ai.

Krasniqi tha se grupi punues ka pasur dy takime deri më tash. Më herët ai kishte thënë se ky udhëzim administrativ do të jetë gati në shtator.

Zgjedhjet e parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës - Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë të Veriut - janë kërkuar nga komuniteti ndërkombëtar për shtensionim të situatës në veri, që është përkeqësuar gati tre muaj më

parë.

Në këto komuna të banuara me shumicë serbe kryetarët e rinj të dalë nga zgjedhjet e bojkotuar nga Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - janë shqiptarë. Serbë lokalë kanë protestuar që nga 29 maji kundër hyrjes së tyre në objektet komunale.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune.

Ky peticion, sipas Krasniqit, më pas do të dërgohej në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), që do ta verifikonte atë dhe më pas do

Kosova i bashkohet Deklaratës së vendeve të G7-s mbi mbështetjen për Ukrainën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 GUSHT- Republika e Kosovës i është bashkuar Deklaratës së Përbashkët të Vendeve të G7 mbi Mbështetjen për Ukrainën. Kjo deklaratë shpreh mbështetjen e rezervë për përpjekjet e guximshme të Ukrainës për t'i mbrojtur institucionet e veta demokratike prej luftës ilegale dhe të paprovokuar të Rosisë. Duke iu bashkuar kësaj deklaratë, Republika e Kosovës rritet se siguri i fitores për popullin ukrainas, si dhe llogaridhënia e liderëve të Rosisë për krimet e tyre, është e

domosdoshme për ruajtjen e paqes dhe demokracisë, në Evropë dhe më tej. "Pushtimi ilegal dhe i paprovokuar i Ukrainës nga ana e Rosisë, mbetet një kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Çmimi i shkaktuar deri tani, në jetë njerëzish, stagnim ekonomik dhe shkatërrim mjedisor, ka qenë katastrofal për popullin ukrainas. Ne i përshëndesim ata për rezistencën e tyre të guximshme në mbrojtje të vlerave tona të përbashkëta, duke përfshirë demokracinë, të drejtat e njeriut dhe paqen e stabilitetin botëror. Po ashtu u shprehim keqardhjen dhe

ngushëllimet më të thella për humbjet dhe vuajtjet e tyre. Pasojat e konfliktit kanë ndikuar edhe përtej kufijve të Ukrainës. Në përpjekje për të tërhequr vëmendje prej luftës së saj ilegale, Rusia po tenton të destabilizojë Ballkanin Perëndimor, me ndihmën e aleatëve të saj kryesorë autokratikë në rajon", thuhet në deklaratën e nënshkruar nga kryeministri Albin Kurti. Më tej në këtë deklaratë thuhet se prej ditës së parë të konfliktit, Republika e Kosovës po qëndron krahas Ukrainës dhe popullit të saj pa rezervë. "Menjëherë e kemi dënuar pushtimin dhe u jemi

bashkëngjitur sanksioneve të ShBA-së dhe BE-së kundër Rosisë. Kemi shprehur gjithashtu gatishmërinë tonë për të pranuar deri në 5 000 refugjatë nga konflikti dhe kemi mirëpritur në Kosovë 18 gazetarë ukrainas, duke iu ofruar një vend të sigurt ku mund ta vazhdojnë misionin e tyre për t'ia thënë të vërtetën pushtetit. Tani që lufta ilegale e Rosisë po zgjatë, duke hyrë thellë në vitin e saj të dytë, Republika e Kosovës, përmes kësaj letre, i bashkohet Deklaratës së Përbashkët të Vendeve të G7 mbi Mbështetjen për Ukrainën. Tani më shumë se kurrë, bota

demokratike duhet të flasë me një zë, drejt një qëllimi të përbashkët", thuhet në deklaratë, për të vazhduar tutje se siguri i fitores për popullin ukrainas, si dhe llogaridhënia e liderëve të Rosisë për krimet e tyre, është e domosdoshme për ruajtjen e paqes dhe demokracisë, në Evropë dhe më tej. "Prandaj, Republika e Kosovës mbetet e gatshme për t'u kontribuar përpjekjeve të parashikuara në Deklaratën e Përbashkët dhe mbështet plotësisht synimet dhe vlerat e shpallura në të", është thënë në deklaratën nënshkruar nga kryeministri Kurti.



Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, para një jave në një takim me gazetarë ka theksuar se mbajtja e zgjedhjeve në katër komunat veriore të banuara me shumicë serbe është një nga pikat që është identifikuar nga BE-ja si diçka që mund ta shtensionojë situatën në këtë pjesë të vendit, dhe se ShBA-ja pajtohet me këtë kërkesë. "Jemi të shqetësuar sa i përket situatës në veri të Kosovës dhe i kemi kërkuar qeverisë të marrë masa. I kemi kërkuar edhe Qeverisë së Serbisë të marrë masa për ta arritur shtensionim në veri të Kosovës. Ne duam të shmangim trazira, kërcënime të dhunës, dhe gjëra të tjera të cilat pengojnë aftësinë tonë për të punuar me palët për t'u fokusuar në

objektivat strategjike, që është zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit nga të dyja palët", ka thënë ambasadori amerikan. Ai ka thënë se Kosova është zotuar se do t'i përmbushë pikat e rena dakord mes kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe emisarit evropian Miroslav Lajçak, në Bratislavë, për shtensionimin e situatës në veri, dhe se ShBA-ja e mirëpret dhe e sheh këtë si hap pozitiv drejt shtensionimit. "Pyetja se si do të mbahen zgjedhjet në veri është pyetje e brendshme për Kosovën. Se a bëhet kjo bëhet përmes dorëheqjes së kryetarëve të komunave, ose nëse bëhet përmes një procesi ku votuesit votojnë për t'i larguar kryetarët aktualë (peticioni)... Ne jemi të

interesuar vetëm të shohim procesin që po ecën para", ka thënë Hovenieri, duke shtuar se ShBA-ja pret që serbët që jetojnë në veri, kësaj radhe, të marrin pjesë në zgjedhje. Duke folur për kryetarët aktualë të komunave në veri - të cilët ka thënë se ShBA-ja i njeh si të ligjshëm pa marrë parasysh mënyrën se si është zhvilluar situata më pas - ai ka theksuar se mendon se asnjë kryetar i zgjedhur me më pak se 4 për qind të votave "mund të ndihet se ka mandat gjithëpërfshirës". Në Bratislavë, më 10 korrik, Kosova dhe BE-ja janë pajtuar për hapa drejt shtensionimit të tensioneve në veri, ku janë përfshirë tërheqja e policisë dhe mbajtja e zgjedhjeve.

KQZ-ja e gatshme t'i organizojë zgjedhjet e reja në veri

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është i gatshëm t'i organizojë zgjedhjet e reja në komunat në veri të Kosovës kurdo që i kërkohet nga institucionet përgjegjëse. Kështu ka deklaruar të mërkurën në një prononcim për Telegrafin zëdhënësi i këtij institucioni, Valmir Elezi. Sipas tij, KQZ-ja si institucion i përhershëm kushtetues e ka për detyrë kryesore organizimin e zgjedhjeve kurdo që ato

shpallen. Prandaj, Elezi ka thënë "se do të merret me të gjitha fazat e organizimit e implementimit të planit". "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion i përhershëm kushtetues, e ka për detyrë kryesore organizimin e zgjedhjeve kurdo që ato shpallen. Si çdoherë, ashtu siç kemi thënë edhe në të kaluarën, KQZ-ja është e gatshme t'i përmbushë detyrat që dalin nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi", ka thënë ai.

Funksionalizohet dhoma e monitorimit të zhurmave në kryeqytet, gjobat deri në 3 mijë euro

PRISHTINË, 21 GUSHT - Dhoma e Monitorimit të Zhurmave dhe pajisjeve për matjen e zhurmës, të instaluar në lokalet e gastronomisë, të

hënën është vënë në funksion. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se të gjitha bizneset që nuk e respektojnë rregulloren në fuqi për nivelin

e zhurmës, do të gjobiten nga 1 000 deri në 3 000 euro. Sipas tij, me vënien në funksion të këtij sistemi që mundëson monitorimin online, fillimisht

do të ketë vërejtje për bizneset e më pas edhe gjoja e, nëse nuk përfillet asnjë masë, mund edhe të ketë mbyllje të biznesit.



Më 26 tetor mbahet seanca për Salih Mustafën

PRISHTINË, 21 GUSHT - Paneli i Gjykatës së Apelit e ka caktuar seancën në çështjen ndaj Salih Mustafës, për datat 26 dhe 27 tetor të këtij viti. Kjo është bërë me dije përmes një urdhri të publikuar në faqen e Gjykatës Speciale. Sipas njoftimit, gjykimi do të mbahet nga ora 13:30 deri në 17:10 me datën 26 tetor, ndërsa nga 09:30 deri në 11:05 një ditë më vonë.

Në muajin shkurt mbrojtja e Salih Mustafës kishte bërë të ditur dorëzimin e nëntë shkaqeve të apelit, pas dënimit me 26 vjet burgim i cili iu shqiptua në dhjetor të vitit të kaluar.

Prokuroria pretendon se Mustafa ka kryer krime lufte dhe akuzat që rëndojnë mbi të janë: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë, vrasje e paligjshme, ndërsa ai është shpallur fajtor për pikën 1, 3

dhe 4.

Gjykimi ndaj Mustafës kishte nisur më 15 shtator të vitit 2021 dhe janë mbajtur seanca në 52 ditë.

Janë tetë persona që janë pranuar si viktima dhe që kanë marrë pjesë në këtë proces gjyqësor, ndërsa janë dëgjuar 13 dëshmitarë të ZPS-së dhe 15 të mbrojtjes.

Shumë nga dëshmitarët e prokurorisë kanë qenë të mbrojtur, identiteti i të cilëve nuk është publikuar.

Në fillim të këtij procesi Salih Mustafa, ndaj të cilit rëndojnë akuza me pretendimin për krime lufte, ishte deklaruar i pafajshëm para trupit gjykues. Sipas Dhomave të Specializuara, "Aktakuza e konfirmuar përcakton se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në një kompleks ndalimi në Zllash, Kosovë, u kryen krimet e



ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe të torturës kundër të paktën gjashtë personave".

Gjithashtu, në aktakuzë thuhet se "në një datë midis 19 prillit 1999, ose rreth kësaj

date, dhe rreth fundit të prillit 1999, në atë vendndodhje u vra një i ndaluar". /kp/

Nxënësit në veri do të kthehen sërish në bankat shkollore

PRISHTINË, 21 GUSHT - Viti shkollor në komunat në veri të Kosovës do të fillojë më 1 shtator në institucionet arsimore dhe nuk do të ketë mësim online, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" drejtori i Shkollës së Mesme Teknike në Leposaviq, Sllagjan Radoviq. Ai ka treguar se për këtë vendim janë njoftuar nga administrata e shkollës për Kosovën, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Arsimit në Qeverinë e Serbisë. Institucionet arsimore në komunitetet serbe në Kosovë punojnë brenda sistemit serb. Disa prindër nga komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës javën e kaluar në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" shprehën shqetësimin se viti shkollor mund të fillojë në një format online për "shkaqe sigurie". Mirëpo drejtori Radoviq pohon se bëhej fjalë



për "dezinformim" dhe se nxënësit do të kthehen sërish në bankat e shkollës.

"Çdo lloj mësimi tjetër, përveç atij të menjëhershëm, do të

ishte i keq, para së gjithash, për studentët", thotë ai.

Mësimi në komunat në veri të Kosovës - Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin

Potok - u ndërpre në fund të majit kur u ngritën tensionet për shkak të hyrjes së kryetarëve shqiptarë në ndërtesat komunale përmes

ndihmës së policisë.

Situata u përshkallëzua më 29 maj në Zveçan, kur protestuesit u përplasën me anëtarët e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Institucionet arsimore në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok janë të vendosura në afërsi të objekteve komunale ku ende ndodhet Policia e Kosovës, ndërsa aty pranë janë edhe pjesëtarët e KFOR-it.

Drejtori i shkollës së mesme në Leposaviq, Sllagjan Radoviq, thekson se nga 1 shtatori KFOR-i duhet të garantojë sigurinë e fëmijëve që shkojnë në shkollë.

Para majit të këtij viti mësimi në komunat në veri të Kosovës ishte ndërprerë edhe më herët për shkak të "përkeqësimit" të situatës së sigurisë, kur u ngritën barrkada për të mos lejuar zbatimin e një vendimi nga autoritetet e Kosovës.

Për një javë policia e rajonit të Ferizajt shqiptoi 1 516 gjoja

FERIZAJ, 21 GUSHT - Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se ka ndërmarrë një sërë aktivitete për identifikimin e kundërvajtësve të ndryshëm në komunikacion me qëllim të parandalimit të aksidenteve. "Në kuadër të këtyre aktiviteteve policia rajonale e Ferizajt gjatë javës që shkoi, nga

data 14-20/08/2023, ka shqiptuar 1 516 gjoja kundërvajtëse, ndërsa ka hequr edhe tetë patentë shoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion", ka njoftuar Policia e Kosovës. Ndërsa janë raportuar 46 aksidente, prej tyre aksidente me lëndime 10,

persona të lënduar 10 dhe aksidente me dëme materiale 36.

Policia Rajonale e Ferizajt ka theksuar se do t'i vazhdojë aktivitetet e shtuara, me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe u ka bërë thirrje shoferëve të kenë kujdes në komunikacion.



Mbajtën grevë për mosdaljen e pagave të korrikut, kombinati Trepça ndëshkon 151 minatorë

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv i Trepçës, Enis Abdurrahmani, ka bërë me dije se borxhet e trashëguara nga menaxhmentet e kaluara, të cilat kapin vlerën mbi 20 milionë euro, kombinati ka arritur që në masë të madhe t'i zvogëlojë falë subvencioneve nga Qeveria e Kosovës. Sipas Abdurrahmanit, duke ristrukturuar disa prej njësive biznesore të ndërmarrjes, Trepça tashmë është në rrugë të mbarë për t'u shndërruar në ndërmarrje profitabile. Ai ka treguar se 151 punëtorë kanë bojkotuar punën pasi kishin mbajtur grevë për mosekzekutimin e pagave për muajin korrik, ku për këta masa financiare do të jetë 176 euro për një punëtor për katër ditë bojkot. "Borxhet e trashëguara janë mbi 20 milionë. Ne kemi arritur në kategori të caktuara t'i reduktojmë dhe zvogëlojmë këto borxhe, këto detyrime të ndërmarrjes. Kemi arritur t'i zvogëlojmë detyrimet nga



kategoria e borxheve që i kemi ndaj ATK-së, mbi 4.2 milionë i kemi zvogëluar borxhet ndaj operatorëve ekonomikë

kontraktuesve mbi 2.5 milionë, kemi arritur t'i reduktojmë borxhet dhe obligimet ndaj KESKO-s dhe KEK-ut", ka thënë

Abdurrahmani për "KosovaPress". Si rezultat i kësaj, shtoi ai, ndërmarrja ka arritur të

nënshkruajë marrëveshje për investime kapitale mbi 15 milionë euro si dhe për ndarje të një fondi kapital punues për ndërmarrjen. "Trepça gjatë këtyre dy viteve ka pasur progres të madh, ka bërë kthesa të mëdha nga një ndërmarrje pothuajse e falimentuar me mbi 20 milionë borxhe, kemi arritur si menaxhment, por edhe si bord, falë angazhimit të ministres së Ekonomisë ta rikthejmë ndërmarrjen në trasenë e rentabilitetit. Si rezultat i kësaj kemi arritur të nënshkruajmë marrëveshje për investime kapitale mbi 15 milionë euro dhe për ndarje të një fondi kapital punues për ndërmarrjen, meqë ndërmarrja ka trashëguar borxhe dhe obligime nga menaxhmentet e kaluara", shtoi ai. Abdurrahmani potencoi se Trepça ka pranuar mbi 210 praktikantë në afat kohor prej gjashtë muajsh për t'i përgatitur ata për punë, 50 prej të cilëve do të punësohen nga 1 shtatori i këtij viti.

Diaspora solli në Kosovë 77 milionë euro më shumë se vitin e kaluar

PRISHTINË, 21 GUSHT - Diaspora e Kosovës edhe këtë vit ka vazhduar të jetë kontribuuese për Kosovën. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për gjashtëmuajorin e parë të këtij viti ka rritje të dërgesave nga diaspora. Besnik Kada nga Banka Qendrore e Kosovës ka thënë se gjatë periudhës janar-qershor 2023 shuma e remitancave është rreth 633 milionë euro. "Krahasuar me 555 milionë e 400 mijë euro në vitin 2022, kemi rritje prej 77.5 milionë eurosh më shumë krahasuar me gjashtëmuajorin e njëjtë të vitit paraprak", ka thënë Kada për RTK-në. Ai bëri me dije se shteti nga i cili më së shumti janë regjistruar remitancat është Gjermania. "Në tremujorin e parë të këtij viti nga Gjermania kanë ardhur 38.8 milionë euro, në ndërkohë vitin e kaluar, pra gjatë 12 muajve, nga Gjermania kanë ardhur 161.5 milionë euro. Në ndërkohë nga Zvicra në tremujorin e parë kanë

ardhur 17.2 milionë, pasuar nga ShBA-ja me 7.6 milionë euro, Austria dhe Italia me nga 4.8 milionë secila", ka deklaruar ai. Kurse njohësi i ekonomisë, Safet Gerxhaliu, ka thënë se me të dhënat e fundit nga BQK-ja, ku shihet se ka rritje të remitancave, edhe një herë dëshmohet se po vazhdon edhe më tutje solidarizimi i diasporës me Kosovën. "Kur shohim se diaspora ka dërguar mbi 77 milionë euro më shumë këtë vit sesa në vitin 2022, është dëshmi se diaspora është njëra ndër shtyllat kryesore të përkrahjes së Kosovës", ka thënë ai. Gerxhaliu ka kërkuar të shikohet mundësia që këto mjete të orientohen në zhvillim dhe të mos mbeten vetëm për konsum, por të jenë të kanalizuar në shërbim të zhvillimit dhe rimëkëmbjes ekonomike të Kosovës. Ai vlerësoi se duhet të ketë më shumë fokus ndaj diasporës që ajo të mos mbetet vetëm si mjet për dërgimin e parave.





Nis ndërtimi i rrugës që lidh Kosovën me pjesën veriore të Shqipërisë



Gjakovë, 21 gusht - Kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka bërë me dije se ka nisur projekti që lidh Kosovën me pjesën veriore të Shqipërisë, Tropojën dhe Bajram Currin. Ai ka thënë se ky projekt është shumë i

rëndësishëm për komunën e Gjakovës dhe më gjerë, pasi është rrugë e karakterit kombëtar. "Bëhet fjalë për daljen për Rekë të Keqe dhe 'Qafë Morinë', e cila lidh Kosovën me pjesën veriore të

Shqipërisë, Tropojën dhe Bajram Currin. Një projekt si ky është shumë i rëndësishëm për Gjakovën dhe më gjerë, sepse kjo rrugë është e karakterit nacional", ka shkruar Gjini në "Facebook".



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Krasniqi: Brahimi dëshironte që vetëm boksierët e klubit të tij ta përfaqësojnë Kosovën



PRISHTINË, 21 GUSHT - Përfaqësuesja e Kosovës në boks ka mbetur pa trajner pasi Besim Brahimi ka dhënë dorëheqje. Këtë vendim Brahimi thotë se e mori për shkak se ka pasur ndërhyrje nga kryetari i Federatës së Boksit, Enver Krasniqi, në përzgjedhjen e boksierëve për garat ndërkombëtare, por edhe për shkak të mospagesës së pagës së rregullt. Ai ka thënë për "KosovaPress" se ndërhyrje të tilla nuk mund t'i pranojë në punën e tij nga ana e bordit të federatës dhe se kjo ka sjellë deri në vendimin për dorëheqjen e tij. Më tutje, Brahimi ka thënë se kryetari i Federatës së Boksit, Enver Krasniqi, ka caktuar edhe emrat e

boksierëve që duhet të marrin pjesë në kampionate evropiane dhe botërore. Por, kryetari i Federatës së Boksit, Enver Krasniqi, ka mohuar të ketë pasur ndërhyrje nga ana e tij në përzgjedhjen e boksierëve, derisa ka thënë se Brahimi dëshironte që vetëm boksierët e klubit të tij ta përfaqësonin Kosovën në arenën ndërkombëtare. "Sa e kemi vërejtur ne është se ai kohët e fundit ka pasur dëshirë që vetëm boksierët e klubit të tij ta përfaqësojnë Kosovën. Bordi ka vendosur që selektori të jetë i krejt Kosovës dhe jo i një ekipi. Duhet t'i jepet secilit boksier nga një shans", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa sa i përket pagës, Krasniqi ka

thënë se bordi ka paraparë që trajnerët mund të paguheshin ose të marrin mëditje vetëm nëse ka donatorë nga jashtë. Brahimi ka paralajmëruar se në drejtim të tij dhe të boksierëve ka ardhur një ofertë nga Maqedonia e Veriut dhe se mund të marrin vendim që të largohen nga Kosova për ta përfaqësuar këtë shtet. Sa i përket kësaj çështje, kryetari i Federatës së Boksit thotë se ky është një vendim i trajnerit dhe se mund të bëjë çfarë të dojë. Pas këtyre zhvillimeve, Krasniqi ka bërë me dije se së shpejti Bordi i Federatës së Boksit do të mbledhet për ta emëruar trajnerin e ri të Kosovës.

SHKURT

Agim Agushi e thyen edhe një rekord botëror

Zhongleri i njohur i Kosovës, Agim Agushi, vazhdon të thyejë rekorde botërore. Agushi rekordin e radhës botëror e ka thyer në Kalanë e Prizrenit. Agushi këtë radhë hyri në librin e rekordeve botërore "Guinness" në disiplinën e veshjeve-zhveshjeve të fanellave sportive. Një gjë të tillë rekordmeni i shumëfishtë botëror i zhonglimeve të topit me kokë, kësaj here e bëri në çift së bashku me Bujar Ajetin.

Operohet me sukses Rilind Nimani

Mesfushori i FC Prishtina, Rilind Nimani, pas lëndimit të pësuar ditë më parë, është operuar me sukses. Nimani është operuar në spitalin "Royal Medical", te mjeku Qerim Kida, në miniskun lateral dhe atij medial. "Klubi e falënderon doktorin Kida dhe stafin e tij për kujdesin e veçantë. FC Prishtina i dëshiron shërim të shpejtë Rilindit dhe shpreson se do ta kalojë këtë sfidë së shpejti. Forca Rilind!", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

KB Prishtina përforcohet me Nick Ward

KB Sigal Prishtina ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me Nick Ward. Qendra e fuqishme Ward vjen në kryeqytet nga skuadra elitare kanadeze e Vancouverit. Amerikani 25-vjeçar ka pasur karrierë të suksesshme edhe në disa kampionate duke u shquar me dominimin e tij nën kosh me mesatare standarde të dyshifrorit të dyfishtë të pikëve të shënuara dhe kërcimeve për ndeshje. Kampionati i basketbollit do të nisë në muajin shtator.

Guardiola: Do të ishte një ëndërr që realizohet nëse Silva rinovon kontratën

Trajneri Pep Guardiola shpreson që mesfushori portugez Bernardo Silva të nënshkruajë një kontratë të re me Manchester Cityn. Kontrata aktuale skadon në vitin 2025, por në gjurmë të 29-vjeçarit janë vënë mjaft skuadra të mëdha në Evropë dhe në Arabi. "Do të ishte një ëndërr që realizohet nëse Bernardo do të rinovojë. Shpresoj shumë që kjo gjë të ndodhë, ashtu sikurse ndodhi me Kyle Walker. Për fat të mirë rinovimi i kontratës së tij ndodhi", u shpreh Guardiola.

Luiza Gega rrezikon pjesëmarrjen në Botërorin e Atletikës

Tiranë, 21 gusht - Kampionia Luiza Gega rrezikon pjesëmarrjen në Botërorin e Atletikës që po zhvillohet në Budapest të Hungarisë. Shkak është bërë një lëndim në kofshë, i cili rrezikon ta lërë jashtë

garave. Prej rreth dhjetë ditëve 34-vjeçarja është në fizeoterapi, me shpresën se do të rikuperohet dhe do të marrë pjesë në garë. Ajo është në luftë me kohën, sepse gjysmëfinalët e garës së 3 000 metrave me

pengesa do të zhvillohen këtë të mërkurë, me datë 23 gusht. Shpresa është rekordmenia kuqezi të zbrësë në pistë në formën më të mirë dhe më pas të sigurojë një vend në finalen e 27 gushtit në Budapest.



Futbollistja spanjolle e kuptoi se i vdiq babai pasi e fitoi Kupën e Botës

Madrid, 21 gusht - Ndonjëherë gëzimi i madh, festa dhe lumturia dinë të kthehen në hidhërim, pikëllim e mërzë. Kjo i ndodhi mbrëmë futbollistes spanjolle Olga Carmona. Ajo ishte protagoniste në finalen e

Kupës së Botës, duke e shënuar golin e fitores ndaj Anglisë. Olga ishte njeriu më i lumtur në botë dje pasi kapitenia ia siguroi trofeun më të çmuar Kombëtares së Spanjës. Por, ajo s'mund ta imagjinonte dot se çka po e

priste pak orë më vonë. Pas përfundimit të festës me Kombëtaren, Carmona mori vesh se babai i saj kishte ndërruar jetë, duke iu kthyer kështu përmbys krejt bota dhe duke e harruar suksesin historik që e arriti. "Dhe, pa e

ditur unë kisha yllin tim para se të fillonte ndeshja. E di që ma ke dhënë forcën për të arritur diçka unike. E di që më ke parë sonte dhe se je krenar për mua. Pusho në paqe, babi!", ka shkruar futbollistja spanjolle në "Twitter".



Fury: Joshua s'ka dashur kurrë të ndeshet me mua, sfida me Usykun mund të zhvillohet

WYTHENSHAW, 21 GUSHT - Tyson Fury, kampion bote i kategorisë WBC, shpreson se dueli për unifikimin e titujve kampionë bote në peshën e rëndë me Oleksandr Usykun mund të zhvillohet një ditë. Gjithsesi, boksieri britanik nuk është aq optimist për të siguruar një përplasje gjithëbritanike me patriotin e tij Anthony Joshua. "Ne nuk i dimë me të vërtetë arsyet pse Usyk nuk e mori pranoi duelin për t'u ndeshur së bashku në prill. Unë jam i sigurt se ai i ka arsyet e veta. Më pas zbuluam se ka nënshkruar me Skills Challenge, ekipi i boksit të Arabisë Saudite. Pavarësisht nga arsyet e tij, jam i sigurt se ato i përshtaten atij dhe familjes së tij", ka thënë Fury për "Sky Sports" përpara publikimit të dokumentarit të tij të ri Netflix, "At Home With The Furys". "Nëse luftimet janë të disponueshme në atë kohë, atëherë ju i merrni ato dhe nëse ato nuk janë të disponueshme, atëherë nuk mund t'i merrni ato. A do të luftojmë në të ardhmen? Shpresojmë. Do të doja. Gjithmonë kam besuar se është një luftë e lehtë për mua", u



shpreh Fury. Bisedimet e Furyt me Anthony Joshuan gjithashtu ngecën. "Në këtë vit të fundit kam provuar dy ose tri herë, por dueli nuk ka ndodhur për arsye të ndryshme. Nuk jam optimist. Për rreth një javë gjatë negociatave të këtij viti kam qenë shumë optimist", ka thënë kampioni i pamposhtur i botës. "Mendova për vite e vite që unë dhe Joshua do të kishim luftuar me njëri-tjetrin, por ai nuk dëshiron ta përballojë atë sfidë për vite me radhë. Kështu që nuk mund ta detyrosh dikë të bëjë diçka, pavarësisht sa parà ka, sa shumë

tituj ka ose çfarëdo që i ofrohet. Nuk mund ta detyrosh dikë të bëjë diçka që nuk dëshiron ta bëjë. Nëse të dyja palët nuk janë të gatshme, atëherë këto duele nuk do të bëhen, siç e kemi parë gjatë viteve", ka shtuar Fury. Boksieri britanik po përgatitet për një duel me ish-kampionin e peshave të rënda të UFC-së, Francis Ngannou. Ky duel do të zhvillohet në tetor. "Unë mendoj se është freskuese që këta djem duan të rriten dhe të kenë një sfidë dhe të luftojnë më të mirë në boks, që vijnë nga prejardhja e tyre", ka deklaruar Fury.

Verstappen: Kështu e motivoj veten për të fituar sa më shumë

Milton Keynes, 21 gusht - Max Verstappen riktheu "numrin 1" në makinat e Formulës 1 vitin e kaluar, kur fitoi titullin e parë kampion bote. Duke folur për mediet, në prag të rikthimit në pistë pas pushimeve verore, piloti holandez i Red Bullit shprehet se bën një punë të fortë bindëse me veten për të qenë kompetitiv në çdo garë. "Një pilot duhet gjithnjë të jetë i bindur për aftësitë e tij, në të kundërtën nuk do të ketë kurrë sukses. Edhe nëse nuk je piloti më i mirë, duhet ta futësh këtë koncept te vetja dhe njerëzit që të rrethojnë, në mënyrë që edhe të tjerët të mendojnë kështu. Unë kurrë nuk them se nuk jam më i miri, përkundrazi", ka thënë Verstappen. "Kujtoj vitin 2018, kur pas garës së Montekarlo



në mendjen time shtypa butonin për të rinisur gjithçka nga e para. Në ato momente mendova të hidhja poshtë gjithçka dhe ta rinisja nga e para. Që nga gara e radhës gjërat

shkuan shumë më mirë. Ndaj e konsideroj veten pilotin më të mirë aktualisht në pistë dhe kjo më ndihmon të fitoj", ka shtuar Verstappen.

SHKURT

Olmo: City është skuadra më e mirë, por jam i lumtur në Leipzig

Manchester City po e kërkon Dani Olmon, por spanjoli e ka refuzuar ofertën e tij. Mediet në Angli dhe Gjermani kanë raportuar se City ka dërguar një ofertë në drejtim të RB Leipzig për Dani Olmon, por spanjoli e ka refuzuar pasi dëshiron të mbetet pjesë e skuadrës gjermane. "Nuk ka asgjë me Manchester Cityn. Jam i fokusuar në punën time te Leipzig, në Bundesligë, Ligën e Kampionëve dhe Kupën e Gjermanisë. City është një nga skuadrat më të mira në botë, Josko Gvardiol shkoi atje, por unë jam i lumtur këtu", u shpreh Olmo.

Xavi: Gundogani e ka ADN-në e Barcelonës

Barcelona e shijoi fitoren e parë në La Liga pasi e mposhti Cadizin me rezultat 2-0. Një nga futbollistët më të mirë në këtë ndeshje padyshim ishte mesfushori gjerman Ilkay Gundogan, i ardhur këtë verë te Barcelona nga Manchester City. Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, nuk i ka kursyer fjalët e mira për mesfushorin gjerman, duke thënë se ai ka ADN-në e katalunasve. "Gundogan është një gur themeli për ekipin. Ai ka ADN-në e Barçës. Ai kurrë nuk e humb topin, bën dallimin dhe gjithmonë merr vendimin e duhur. Ne nënshkruam me atë për të bërë dallimin dhe ai këtë po e bën", ka thënë Xavi.

Unitedi në garë për Verratin

Manchester Unitedi është interesuar për mesfushorin italian të PSG-së, Marco Verrati. Sipas "L'Equipe", Verrati ka rënë në radarët e klubit anglez të drejtuar nga Luis Enrique. Drejtuesit e Manchester Unitedit po bëjnë vlerësimin për një ofertë të mundshme për mesfushorin, pasi për ta pista Sofyan Amrabat është e mbyllur. Për Verratin interes ka pasur edhe nga Al Ahli dhe Bayern Muncheni.

Frankfurti refuzon ofertën e PSG-së për Kolo Muanin

Skuadra kampionë në fuqi e Ligës 1, PSG, ka përgatitur ofertën e parë zyrtare për sulmuesin 24-vjeçar Randal Kolo Muani, që luan në Bundesliga me Eintracht Frankfurtin. Klubi francez ka ofruar 65 milionë euro për 24-vjeçarin, por kjo ofertë është refuzuar nga gjermanët. Sipas "Sky Germany", skuadra e Bundesligës kërkon 100 milionë për të lënë të lirë sulmuesin, që sezonin e kaluar realizoi 23 gola në 46 ndeshje me Eintrachtin. Madje ai e nisi me gol edhe këtë sezon. Kolo Muani ka një kontratë deri në vitin 2027 me skuadrën gjermane, por ai është vënë në shënjestrën e PSG-së, që kërkon një zëvendësues pas largimit të Neymarit. Francezët e konsiderojnë të lartë kërkesën e Eintrachtit për 100 milionë euro, ndaj synojnë të gjejnë një zgjidhje të mesme brenda 31 gushtit.

Klopp: Vështirë të konkurrosh me Chelsean dhe vendet arabe


Afati kalimtar i verës ka qenë i nxehtë. Të shumtë ishin lojtarët që kanë lënë Evropën për të kaluar në kampionatin arab, që në këtë merkato ka investuar jashtëzakonisht shumë. Kjo e ka shqetësuar jo

pak trajnerin e Liverpoolit, Jurgen Klopp, i cili në një intervistë është shprehur se investime të tilla po shkatërrojnë futbollin. Ai ka shtuar se është e pamundur të rivalizosh në merkato me

klube si Chelsea apo edhe arabët që po investojnë pa fund. "Është problem kur ka shumë para pasi sot është e vështirë të konkurrosh me Chelsean dhe vendet arabe. Arsyet për këtë i dimë të gjithë.

Disa klube e menaxhojnë fushatën e tyre të transferimit ndryshe nga të gjithë të tjerët dhe askush nuk e kupton 100% se si funksionon. Është shumë e vështirë për ne, si një klub normal. Ajo që po bëjnë

është në rregull. Unë nuk gjykoj askënd, por merkatoja jonë mbyllet pas pak ditësh dhe në Arabi mbyllet pas tri javësh. Kjo do të jetë një tjetër vështirësi për ne", ka thënë Klopp.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Miran Dana shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

Florent Susuri shpall te pavlefshme diplomën, vërtetimin e notave dhe mungesave QK "11 Marsi " Prizren.

Shkumbin Sopaj shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

Reshit Reshiti shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " 28 Nëntori " Brodosan Dragash.

Bashkim Berisha shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

Toni Dedaj nga Gajkova shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I deri 9 të shkollës "Gjergj Fishta".

Kastriot Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi.

Granit Isa Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

Agron Caka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme QAMO Elektro Teknike "Nexhmedin Nixha"

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

